

RAPORTI VJETOR

Sektori i Burimeve Njerëzore

2022 / 2023



PRISHTINA

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	2
HYRJE.....	3
DIGJITALIZIMI I DOSJEVE TË SHËRBYESVE CIVIL.....	3
KONKURSET E BRENDSHME: LËVIZJET PARALELE.....	4
KONKURSET E BRENDSHME: NGRITJE NË DETYRË/ AVANCIM.....	11
KONKURSET E JASHTME: PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL.....	12
KONKURSET PËR PRANIM NË SHËRBIMIN PUBLIK.....	16
KONKURSET PËR PRANIM SI STAF ADMINISTRATIV/ TEKNIK.....	18

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i përgatitur paraqet fluksin e punës kryesisht për procesin e rekrutimit nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore për vitet 2022-2023, duke pasqyruar të dhënat sasiore se si kemi proceduar me fazat e rekrutimit varësisht nga lloji i procedurës së rekrutimit. Gjithashtu përmenden në mënyrë të përgjithëshme edhe llojet e shërbimeve dhe natyra e punës të cilën e kryejmë duke përmendur edhe natyrën e akteve, organizimit të ngritjes së kapaciteteve për shërbyesit civil si dhe punët/angazhimet tjera që janë listuar në vazhdim gjatë këtij raporti. Me qenë se është e pamundur prezantimi i indikatorëve për numrin e palëve të cilat janë shërbyer, jemi fokusuar në indikatorët për procedurat e rekrutimit të cilat për çdo kategori janë të pasqyruara në vazhdim.

Nga procedurat e brendshme të cilat i kemi menaxhuar janë gjithësej **117 procedura**, për të cilat në vazhdim janë të paraqitura detajet respektive në kuadër të raportit. E rëndësishme është që krahas këtyre procedurave të përmendim plotësimin e nevojave të shumë drejtorive për lëvizje paralele për shërbyesit civil, duke u përgjigjur në kërkesat e tyre si dhe plotësimin të pozitivave të caktuara. Poashtu sa i përket konkurseve për avancim, janë shpallur dhe menaxhuar **17 procedura të rekrutimit duke rekrutuar 9 kandidatë si udhëheqës të sektoreve (niveli drejtues i ultë)**, për të lehtësuar punën dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e kryeqytetit.

Tek procedurat e rekrutimit për pranim (konkurset e jashtme), janë menaxhuar **62 procedura të rekrutimit** që kanë ofruar plotësim të resurseve njerëzore për shumë dikastere për të lehtësuar punën e manxhimit të lëndëve për palët. Duke qenë se për kohë të gjatë numri i rekrutimit të stafit ka qenë në numër minimal për këto dy vite kemi arritur që të zbusim mungesën e stafit në shumë dikastere, për të përmbushur kërkesat e qytetarëve që parashtrajnë në kryeqytet. Janë rekrutuar apo janë në proces të rekrutimit **87 shërbyes civil** për të përmbushur nevojat e kryeqytetit për drejtoritë respektive.

Tek Shërbimi Publik për shkak të shtrirjes së madhe të natyrës së shërbimeve të ofruara në Arsim dhe Shëndetësi, vlenë të përmendët që kanë qenë një numër i madh i aplikantëve për pozitat e parashikuara në kuadër të kësaj kategorie. Për vitet 2022 dhe 2023 në Shërbimin Publik janë **rekrutuar 355 persona gjatë konkurseve** të cilat janë shpallur dhe menaxhuar gjatë këtyre viteve, ku poashtu kemi plotësuar nevojat e atypëratyshme të shkollave dhe institucioneve tjera edukative për staf në rastet kur jemi përballur me dorëheqje, pushime të lehonisë apo mungesa tjera që kanë shtyer në angazhimin e shërbyesve publik. **Tek shëndetësia për vitin 2023 janë rekrutuar 43 persona** në profile të ndryshme për Institucionet Shëndetësore të Nivelit Primar për të mbuluar llojet e shërbimeve të cilat ofron kryeqyteti.

Tek Stafi Administrativ/ Teknik janë rekrutuar 9 persona si dhe disa janë në procedurë të rekrutimit, për të plotësuar nevoja specifike për institucionin e kryeqytetit apo specifikisht për institucione vartëse. Gjatë kësaj periudhë janë verifikuar edhe kandidatët për Konkursin Zyrtar Administrativ KP1 dhe KP2, por pas ankesës së palëve nuk është proceduar tutje me këtë procedurë të rekrutimit. Për të gjitha të dhënat janë të listuara tabelat dhe grafikonet në vazhdim të raportit, ku janë të identifikuara në detaje cdo procedurë e rekrutimit.

HYRJE

Sektori i Burimeve Njerëzore të Kryeqytetit për Vitet 2022-2023, konform përgjegjësiwe ligjore ka shpallur dhe administruar Konkursët në Lëvizje Paralele, Avancim dhe Pranim për Shërbyesit Civil, ka shpallur dhe administruar Konkursët për Shërbyesit Publik si dhe për Stafin Administrativ Mbështetës. Gjatë kësaj kohe konform Planeve të Personelit të miratuara paraprakisht, jemi munduar të përmbushim nevojat e Kryeqytetit për staf, duke llogaritur numrin e të pensionuarve, vendeve të lira dhe dorëheqjeve eventuale për të garantuar vazhdimësinë e punës në Shërbimin Civil dhe Shërbimin Publik të Kryeqytetit. Konform këshillave nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil, kemi organizuar arkivën e dosjeve personale të nëpunësve, ku janë të ruajtuara dosjet dhe organizuara në bazë të Drejtorive/Sektorëve, ku ata janë duke punuar. Gjithashtu krahas punës së përditshme, nëpunësit janë shërbyer me vërtetime pune, vendime për pushime (pezullim vullnetar, pushim vjetor, pushim mjekësor, pushim të lehonisë), vendime për përfundim të mardhënies së punës, vendime për pensionimin e tyre dhe shërbime tjera të ngjajshme të karakterit administrativ.

Për të garantuar respektimin e kornizës ligjore për Zyrtarët Publik, si sektor kemi themeluar komisionet: Komisioni Disiplinor për Shërbyes Civil, Komisioni Disiplinor për Shërbyes Publik dhe Staf Administrativ/ Teknik, Komisionin e Ankesave për Shërbyes Publik dhe Staf Administrativ/ Teknik (në të kaluarën me ligjin paraprak komisioni i ankesave ka funksionuar edhe për shërbyesit civil, mirëpo kjo mundësi është eliminuar me ndryshimin e ligjit). Gjithashtu Sektori i Burimeve Njerëzore, përgatit dhe organizon ngritjen e kapaciteteve të Zyrtarëve Publik, duke marrë për bazë nevojat dhe kërkesat tjera profesionale nga Drejtoritë dhe Sektorët e Kryeqytetit, për të arritur performancë më të mirë dhe realizuar detyrat e përditshme përmes së cilave obligohet administrata dhe shërbyesit publik të ofrojnë shërbime të caktuara.

Sektori i Burimeve Njerëzore në përmbushje të mandatit dhe obligimeve ligjore që dalin nga Ligji për Zyrtarët Publik dhe Ligjet tjera, gjithashtu ka kryer vlerësimin e performancës, mbledhjen dhe vendosjen e vlerësimeve individuale në dosjen e çdo nëpunësi, formalizuar mardhënien e punës përmes aktemërimeve dhe procedurave tjera të ngjajshme që janë në funksion të mbështetjes dhe organizimit të punës së nëpunësve të Komunës së Prishtinës.


DIGJITALIZIMI I DOSJEVE TË SHËRBYESVE CIVIL

Regjistrimi i dosjeve të shërbyesve civil në Sistemin Informativë të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), ka qenë një kërkesë nga Ministria për Komunën e Prishtinës tash e pesë vite. Ne si Njësi e Burimeve Njerëzore në Shtator 2022 kemi filluar regjistrimin e dosjeve të shërbyesve civil në SIMBNJ dhe me një përkushtim maksimal me staf minimal kemi arritur që të përfundojmë këtë proces me një efikasitet të plotë, ndërsa poashtu edhe për stafin që është rekrutuar gjatë vitit 2023, ne kemi arritur që të bëjmë regjistrimin e tyre për 90 përqind të këtyre punëtorve.

Përditësimi dhe regjistrimi i këtyre dosjeve individuale të shërbyesve civil në SIMBNJ, është shumë e rëndësishme sepse kjo mundëson që të gjitha kërkesat e Shërbyesve Civil për pushim vjetor që në të kaluarën janë bërë manualisht, tash të bëhen nëpërmjet SIMBNJ-së në formë digjitale.

KONKURSET E BRENDSHME: LËVIZJET PARALELE

Sa i përket konkurseve të Lëvizjeve Paralele, kemi shpallur dhe administruar gjithësej 117 Konkurse, nga të cilat kanë aplikuar 246 Kandidatë ndërsa janë përzgjedhur gjithësej 53 Kandidatë.



Grafikoni 1

Shprehur në përqindje gjithësej 21.54% e Kandidatëve që kanë aplikuar janë shpallur fitues për pozitat e reja të punës, ndërsa 78.46% nuk janë shpallur fitues për pozitat e reja të cilat ata kanë aplikuar. Për të dhëna më të detajuara rreth Lëvizjeve të Brendshme, shih të bashkangjitur Tabelën 1:

Nr.	Pozita	Njësia	Konkursi	Numri i aplikantëve	Numri i kandidatëve të suksesshëm
1.	Zyrtar çertifikues	Komuna Prishtinë	RPC0006014	6	1
2.	Zyrtar për arsimin parashkollor dhe fillor	Komuna Prishtinë	RPC0005928	0	0
3.	Zyrtar për Arkiv 1	Drejtoria e Urbanizmit	RPC0005871	1	0
4.	Zyrtar i Lartë për Kulturë, Rini dhe Sport	Drejtoria e Sportit	RPC0005577	2	1
5.	Zyrtar për të Drejta dhe Integrim të Komuniteteve	Sektori për Komunitete dhe Kthim	RPC0005540	0	0

Data: 11.01.2024

Raporti Vjetor 2022/2023 – Sektori i Burimeve Njerëzore

Nr. i Protokollit: 14-052/01-0005847/24

6.	Zyrtar për Mbrojtje të Mjedisit	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm	RPC0005516	1	0
7.	Inspektor i Shërbimeve Publike	Drejtoria e Inspeksionit	RPC0005513	0	0
8.	Zyrtar i Lartë për Përkthime	Kabineti i Kryetarit, Sektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Qytete	RPC0005300	1	0
9.	Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrje të Ndërtesave Shkollore	Drejtoria e Arsimit	RPC0005271	1	1
10.	Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët	Drejtoria e Arsimit	RPC0005270	1	0
11.	Zyrtar për Mbikëqyrje të Ndërtesave Shkollore	Drejtoria e Arsimit	RPC0005268	1	0
12.	Zyrtar i Lartë për Arsimin Joformal	Drejtoria e Arsimit	RPC0005267	3	1
13.	Zyrtar i Lartë për Çështje Pronësore	Drejtoria e Pronës	RPC0005258	3	0
14.	Zyrtar i Lartë për Çështje Pronësore	Drejtoria e Pronës	RPC0005257	3	0
15.	Zyrtar për Shërbime Sociale 2	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendra për Punë Sociale	RPC0005002	4	0
16.	Zyrtar i Lartë për Dhënien e Këshillave Sociale	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendra për Punë Sociale	RPC0005000	5	1
17.	Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme	Drejtoria e Financave, Sektori i Tatimit në Pronë	RPC0004971	0	0
18.	Zyrtar Ligjor 2	Drejtoria e Financave, Sektori i Tatimit në Pronë	RPC0004962	2	0
19.	Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore	Drejtoria e Financave, Sektori për Buxhet dhe Financa	RPC0004954	2	0
20.	Analist i Buxhetit	Drejtoria e Financave, Sektori për Buxhet dhe Financa	RPC0004953	1	0
21.	Zyrtar i Lartë Ligjor	Sektori Ligjor, Kabineti i Kryetarit	RPC0004930	5	2
22.	Zyrtar i Lartë Ligjor	Sektori Ligjor, Kabineti i Kryetarit	RPC0004780	1	0
23.	Zyrtar Ligjor 2	Sektori Ligjor, Kabineti i Kryetarit	RPC0004779	1	0

Data: 11.01.2024

Raporti Vjetor 2022/2023 – Sektori i Burimeve Njerëzore

Nr. i Protokollit: 14-052/01-0005847/24

24.	Zyrtar i Lartë i Personelit	Sektori i Burimeve Njerëzore	RPC0004759	1	0
25.	Zyrtar i Lartë i Personelit	Sektori i Burimeve Njerëzore	RPC0004758	1	0
26.	Zyrtar i Personelit 2	Sektori i Burimeve Njerëzore	RPC0004757	4	0
27.	Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun	Sektori për Komunikim me Publikun	RPC0004654	3	0
28.	Menaxher i Personelit	Sektori i Burimeve Njerëzore	RPC0004650	2	0
29.	Zyrtar i larte për inovacion dhe teknologji	Drejtoria e Arsimit	RPC0004649 RN00010995	1	0
30.	Zyrtar i Lartë për Lektorim	Sektori për Punë të Kuvendit Komunal	RPC0004646	1	1
31.	Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2	Drejtoria e Arsimit	RPC0004623	0	0
32.	Zyrtar për Listat e Pagave për Arsim	Drejtoria e Arsimit	RPC0004622	0	0
33.	Zyrtar për arsimin parashkollor dhe fillor	Drejtoria e Arsimit	RPC0004621	0	0
34.	Zyrtar i Lartë për Arsimin Parashkollor	Drejtoria e Arsimit	RPC0004620	0	0
35.	Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët	Drejtoria e Arsimit	RPC0004614	2	0
36.	Inspektor i Ndërtimit	Drejtoria e Inspekcionit, Sektori i Ndërtimit	RPC0004613	3	0
37.	Asistent Administrativë	Drejtoria e Administratës	RPC0004552	0	0
38.	Referent	Drejtoria e Administratës - Sektori i Bashkësive Lokale	RPC0004551	0	0
39.	Referent	Drejtoria e Administratës - Sektori i Bashkësive Lokale	RPC0004550	0	0
40.	Zyrtar i Lartë për Arkitekturë	Drejtoria e Parqeve	RPC0004537	2	0
41.	Zyrtar i Lartë Ligjor	Drejtoria e Parqeve	RPC0004535	0	0
42.	Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim	Drejtoria e Urbanizmit - Sektori i Urbanizmit	RPC0004531	3	0
43.	Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim	Drejtoria e Urbanizmit - Sektori i Urbanizmit	RPC0004529	6	0
44.	Zyrtar i Lartë për Gjendje Civile	Drejtoria e Administratës - Sektori i Gjendjes Civile	RPC0004522	2	0
45.	Zyrtar i Lartë për Përkthime	Drejtoria e Administratës - Sektori për Punë të Kuvendit Komunal	RPC0004499	1	0

Data: 11.01.2024

Raporti Vjetor 2022/2023 – Sektori i Burimeve Njerëzore

Nr. i Protokollit: 14-052/01-0005847/24

46.	Zyrtar i Lartë për Përkthime	Drejtoria e Administratës - Sektori për Punë të Kuvendit Komunal	RPC0004498	0	0
47.	Zyrtar i Lartë për Lektorim	Drejtoria e Administratës - Sektori për Punë të Kuvendit Komunal	RPC0004497	2	1
48.	Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative	Drejtoria e Administratës - Sektori i Teknologjisë Informative	RPC0004491	6	3
49.	Zyrtar për Integritet Evropiane 1	Kabineti i Kryetarit, Sektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Qytete	RPC0004431	4	0
50.	Zyrtar i Lartë për politika të Turizmit	Drejtoria e Kulturës, Sektori për Turizëm	RPC0004345	2	1
51.	Zyrtar për Biblioteka 1	Drejtoria e Kulturës	RPC0004323	0	0
52.	Zyrtar i Lartë për Integritet Evropiane	Kabineti i Kryetarit, Sektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Qytete	RPC0004282	3	1
53.	Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Mirëqenies Sociale	RPC0004244	1	1
54.	Zyrtar i Lartë për Menaxhim Financiar dhe Kontroll	Drejtoria e Urbanizmit	RPC0004216	1	1
55.	Zyrtar i Lartë për Menaxhim Financiar dhe Kontroll	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendra për Punë Sociale	RPC0004110	1	1
56.	Zyrtar i Lartë i Personelit	Sektori i Burimeve Njerëzore	RPC0004077	5	2
57.	Zyrtar për Shërbime Sociale 1	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Mirëqenies Sociale	RPC0004051	2	1
58.	Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorim	Drejtoria e Inspektionit, Sektori i Pylltarisë	RPC0004044	0	0
59.	Zyrtar i Lartë për Promovim të Kulturës	Sektori i Kulturës	RPC0003993	1	1
60.	Zyrtar i Lartë për Programe dhe Projekte	Sektori i Kulturës	RPC0003992	1	1
61.	Zyrtar Ligjor 2	Sektori Ligjor	RPC0003964	2	1
62.	Menaxher i Personelit	Sektori i Burimeve Njerëzore	RPC0003897	0	0

Data: 11.01.2024

Raporti Vjetor 2022/2023 – Sektori i Burimeve Njerëzore

Nr. i Protokollit: 14-052/01-0005847/24

63.	Zyrtar i të Hyrave Financiare	Drejtoria e Financave	RPC0003882	7	1
64.	Zyrtar për Shpenzime	Drejtoria e Financave	RPC0003881	8	1
65.	Zyrtar i Lartë për Trashëgimi Kulturore dhe Arkiv të Qytetit	Drejtoria e Kulturës	RPC0003804	2	1
66.	Zyrtar i Personelit 1	Sektori i Burimeve Njerëzore	RPC0003728	4	1
67.	Zyrtar i Personelit 2	Sektori i Burimeve Njerëzore	RPC0003727	5	0
68.	Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi	Drejtoria e Kadastrit, Sektori I Kadastrit	RPC0003700	4	2
69.	Zyrtar i Lartë për Punë Profesionale për Kuvendin Komunal	Drejtoria e Administratës, Sektori për Punë të Kuvendit Komunal	RPC0003520	3	2
70.	Zyrtar për Arkiv 1	Drejtoria e Urbanizmit, Sektori i Urbanizmit	RPC0003515	1	0
71.	Zyrtar për financa	Drejtoria e Urbanizmit, Sektori i Urbanizmit	RPC0003514	2	*
72.	Zyrtar për Leje Ndërtimore	Drejtoria e Urbanizmit, Sektori i Urbanizmit	RPC0003513	3	0
73.	Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim	Drejtoria e Urbanizmit, Sektori i Legalizimit	RPC0003512	6	
74.	Zyrtar Ligjor 2	Drejtoria e Urbanizmit, Sektori i Urbanizmit	RPC0003500	2	1
75.	Zyrtar për Mirëmbajtjen e Rrugëve 2	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit	RPC0003408	1	0
76.	Zyrtar i larte për inovacion dhe teknologji	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Sektori i Shërbimeve Publike	RPC0003406	0	0
77.	Zyrtar i Lartë për Menaxhim Financiar dhe Kontroll	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Sektori i Shërbimeve Publike	RPC0003405	2	1
78.	Zyrtar për financa	Drejtoria e Parqeve	RPC0003398	4	0
79.	Zyrtar për Hapësira Publike 2	Drejtoria e Parqeve	RPC0003395	1	0
80.	Zyrtar i Lartë Ligjor	Drejtoria e Parqeve	RPC0003394	1	1
81.	Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim	Drejtoria e Parqeve	RPC0003393	2	0

Data: 11.01.2024

Raporti Vjetor 2022/2023 – Sektori i Burimeve Njerëzore

Nr. i Protokollit: 14-052/01-0005847/24

82.	Zyrtar Administrativ	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Shëndetësisë	RPC0003354	0	0
83.	Zyrtar për Shëndetësi	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Shëndetësisë	RPC0003353	0	0
84.	Zyrtar i lartë për shëndetësi	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Shëndetësisë	RPC0003352	1	1
85.	Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit	RPC0003351	3	1
86.	Zyrtar Ligjor 2	Drejtoria e Sportit, Sektori i Sportit	RPC0003346	1	0
87.	Zyrtar i Lartë për Kulturë, Rini dhe Sport	Drejtoria e Sportit, Sektori i Sportit	RPC0003345	1	1
88.	Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit	RPC0003138	3	0
89.	Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit	RPC0003137	4	1
90.	Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Mbeturinave	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit	RPC0003136	4	1
91.	Zyrtar Administrativ	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit	RPC0003135	0	0
92.	Inspektor i Ndërtimit	Drejtoria e Inspektionit, Sektori i Ndërtimit	RPC0003106	0	0
93.	Zyrtar për Kadastër	Drejtoria e Kadastrit, Sektori i Kadastrit	RPC0003105	0	0
94.	Zyrtar i Lartë për Pylltari	Drejtoria e Inspektionit, Sektori i Pylltarisë	RPC0003086	2	0
95.	Zyrtar Teknik i Pylltarisë	Drejtoria e Inspektionit, Sektori i Pylltarisë	RPC0003083	1	0
96.	Inspektor i Shërbimeve Publike	Drejtoria e Inspektionit, Sektori i Rendit Komunal	RPC0003082	7	0
97.	Zyrtar i Prokurimit 2	Sektori i Prokurimit	RPC0003081	1	0
98.	Zyrtar i Lartë i Prokurimit	Sektori i Prokurimit	RPC0003080	7	1

Data: 11.01.2024

Raporti Vjetor 2022/2023 – Sektori i Burimeve Njerëzore


Nr. i Protokollit: 14-052/01-0005847/24

99.	Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Sektori i Planifikimit Strategjik	RPC0003066	1	0
100.	Asistent Administrativ 3	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Sektori i Planifikimit Strategjik	RPC0003065	0	0
101.	Zyrtar i Lartë për Komunikacion Rrugor	Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Sektori i Menaxhimit të Kontratave të Ndërtimeve të Ulëta	RPC0003051	3	0
102.	Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit	RPC0003046	4	0
103.	Zyrtar i Lartë për Arkitekturë	Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Sektori i Planifikimit Infrastruktural	RPC0003045	3	1
104.	Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari	Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Sektori i Planifikimit Infrastruktural	RPC0003039	2	1
105.	Zyrtar për Gjeodezi	Drejtoria e Kadastrit, Sektori i Gjeodesisë	RPC0003035	1	1
106.	Zyrtar për Kadastër	Drejtoria e Kadastrit, Sektori I Kadastrit	RPC0003034	2	0
107.	Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi	Drejtoria e Kadastrit, Sektori I Kadastrit	RPC0003032	2	0
108.	Zyrtar për Çështje Psikologjike	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Mirëqenies Sociale	RPC0003022	0	0
109.	Zyrtar i Lartë për të Drejta të Fëmijëve	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendra për Punë Sociale	RPC0003021	1	0
110.	Zyrtar i Lartë për Dhënien e Këshillave Sociale	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendra për Punë Sociale	RPC0003020	7	3
111.	Zyrtar Certifikues	Drejtoria e Financave, Sektori për Buxhet dhe Financa	RPC0003019	6	2

112.	Arkëtar	Drejtoria e Financave, Sektori për Buxhet dhe Financa	RPC0003018	0	0
113.	Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa	Drejtoria e Financave, Sektori për Buxhet dhe Financa	RPC0003016	4	1
114.	Zyrtar për Shërbime Sociale 1	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Mirëqenies Sociale	RPC0003008	1	1
115.	Zyrtar për Shërbime Sociale 1	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendra për Punë Sociale	RPC0003007	1	0
116.	Zyrtar për Shërbime Sociale 2	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendra për Punë Sociale	RPC0003005	5	3
117.	Asistent Administrativ 4	Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave	RPC0002067	3	1

KONKURSET E BRENDSHME: NGRITJE NË DETYRË/ AVANCIM

Për sa i përket konkurseve për Ngritjet në Detyrë / Avancim, janë shpallur 17 Konkurse për Udhëheqës të Sektorëve, konkurse në të cilat kanë aplikuar 18 aplikantë, si dhe janë shpallur 9 kandidatë fitues që janë përzgjedhur si të suksesshëm. Aktualisht janë të mbuluara disa Sektor dhe Njësi me Ushtrues Detyre, pozita për të cilat janë përgatitur konkurset të shpallen gjatë vitit 2024.



Grafikoni 2

Data: 11.01.2024

Raporti Vjetor 2022/2023 – Sektori i Burimeve Njerëzore


Nr. i Protokollit: 14-052/01-0005847/24

Shprehur në përqindje 50% e kandidatëve janë shpallur fitues në konkurset për Ngritje në Detyrë / Avancime, ndërsa 50% e këtyre konkurseve për Ngritje në Detyrë / Avancime nuk janë shpallur fitues. Për të dhëna më të detajuara të konkurseve për avancim, shih të bashkangjitur Tabelën 2, në vazhdim:

Nr.	Pozita	Njësia	Numri i aplikantëve	Numri i kandidatëve të suksesshëm
1.	Udhëheqës i Sektorit të Turizmit	Drejtoria e Kulturës	2	0
2.	Udhëheqës i Sektorit Ligjor	Sektori Ligjor	2	1
3.	Udhëheqës i Sektorit për Punë të Kuvendit Komunal	Drejtoria e Administratës	1	1
4.	Udhëheqës i Sektorit të Legalizimit	Drejtoria e Urbanizmit	2	1
5.	Udhëheqës i Sektorit të Urbanizmit	Drejtoria e Urbanizmit	1	1
6.	Udhëheqës i Sektorit të Rendit Komunal	Drejtoria e Inspektionit	1	1
7.	Udhëheqës i Sektorit të Ndërtimit	Drejtoria e Inspektionit	0	0
8.	Udhëheqës i prokurimit	Sektori i Prokurimit	0	0
9.	Udhëheqës i Sektorit për Investimeve Kapitale	Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave	0	0
10.	Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm	Sektori i Auditimit të Brendshëm	0	0
11.	Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale	Drejtoria e Mirëqenies Sociale	1	1
12.	Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale	Drejtoria e Mirëqenies Sociale	1	1
13.	Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale	Drejtoria e Mirëqenies Sociale	1	1
14.	Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale	Drejtoria e Mirëqenies Sociale	3	1
15.	Udhëheqës i Sektorit për Mbështetje dhe Logjistikë	Drejtoria e Administratës	0	0
16.	Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile	Drejtoria e Administratës	2	0
17.	Udhëheqës i Sektorit për Pronë	Drejtoria e Financave	1	0

KONKURSET E JASHTME: PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Në 62 konkurse për pranim të shpallura nga Kryeqyteti, kanë aplikuar gjithësej 2,440 Kandidatë, ku janë përzgjedhur 87 Kandidatë të Suksesshëm. Procedura si në konkurset paraprake ka qenë verifikimi paraprak i çdo kandidati, të cilët pastaj kanë vazhduar tutje me procedurat tjera të definuara.



Grafikoni 3

Shprehur në përqindje 3.56% e kandidatëve janë shpallur fitues në konkurse për pranim, ndërsa 96.44% të tjerë nuk janë shpallur fitues. Për të dhëna më të detajuara të konkurseve të jashtme për pranim në Shërbimin Civil, shih të bashkangjitur Tabelën 3, në vazhdim:

Nr.	Grupi	Konkursi	Numri i aplikantëve	Numri i Kandidatëve të Suksesshëm
1.	Specialistë të Përkthimit dhe Interpretimit - Zyrar i Lartë për Përkthime	RPC0006053	14	1
2.	Specialistë të inxhinierisë të Ndërtimit - Inspektor i Ndërtimit	RPC0006026	17	4
3.	Specialistë të Shkencave Shoqërore - Zyrar për Arsimin e Mesëm të Ulët	RPC0005992	58	1
4.	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm - Zyrar për të Drejta dhe Integrim të Komuniteteve	RPC0005980	48	1
5.	Specialistë të inxhinierisë të Ndërtimit - Zyrar për Mbikëqyrje të Ndërtesave Shkollore	RPC0005979	11	1

Data: 11.01.2024

Raporti Vjetor 2022/2023 – Sektori i Burimeve Njerëzore

Nr. i Protokollit: 14-052/01-0005847/24

6.	Specialistë të inxhinierisë të Ndërtimit - Zyrtar për Mbikëqyrje të Ndërtesave Shkollore	RPC0005937	11	1
7.	Specialistë të Buxhetit - Analist I Buxhetit	RPC0005883	17	1
8.	Specialistë Ligjor - Zyrtar Ligjor 2	RPC0005882	35	1
9.	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm - Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme	RPC0005881	78	5
10.	Specialistë Ligjor - Zyrtar i Lartë I Personelit	RPC0005880	31	1
11.	Specialistë të Shkencave Shoqërore - Zyrtar për Shërbime Sociale 2	RPC0005870	73	5
12.	Specialistë të Përgjithshëm të Mjedisit - Zyrtar për Mbrojtje të Mjedisit	RPC0005834	34	1
13.	Specialistë të Burimeve Njerëzore - Zyrtar I Personelit	RPC0005774	61	2
14.	Specialistë Ligjor - Zyrtar i Lartë i Burimeve Njerëzore	RPC0005455	10	1
15.	Specialistë Ligjor - Zyrtar i Lartë Ligjor	RPC0005329	21	1
16.	Specialistë të Shkencave Shoqërore - Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët	RPC0005276	27	1
17.	Specialistë të inxhinierisë të Ndërtimit - Inspektor i Ndërtimit	RPC0005222	11	0
18.	Specialistë të Arkitekturës - Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim	RPC0005219	21	0
19.	Specialistë Ligjor - Zyrtar i Lartë Ligjor	RPC0005198	30	1
20.	Specialistë të Arkitekturës - Zyrtar i Lartë për Arkitekturë	RPC0005197	20	1
21.	Specialistë të inxhinierisë Mekanike - Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim	RPC0005196	6	0
22.	Specialistë Ligjor - Zyrtar Ligjor 2	RPC0005194	30	1
23.	Specialistë të Arsimit - Zyrtar i Lartë për Arsimin Parashkollor	RPC0005186	17	1
24.	Specialistë të Arsimit - Zyrtar për arsimin parashkollor dhe fillor	RPC0005185	21	1
25.	Specialistë Financiar - Zyrtar për Listat e Pagave për Arsim	RPC0005184	19	1
26.	Specialistë të Buxhetit - Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2	RPC0005182	16	1
27.	Specialistë të marrëdhënieve me publikun dhe informimin / Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun	RPC0005042	25	0
28.	Specialistë të Përkthimit dhe Interpretimit / Zyrtar i Lartë për Përkthime	RPC0004917	11	0

Data: 11.01.2024

Raporti Vjetor 2022/2023 – Sektori i Burimeve Njerëzore


Nr. i Protokollit: 14-052/01-0005847/24

29.	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm / Referent	RPC0004915	205	5
30.	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm / Referent	RPC0004914	151	2
31.	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm / Asistent Administrativë	RPC0004913	146	1
32.	Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës	RPC0004583	32	2
33.	Specialistë të Ekonomisë	RPC0004569	37	0
34.	Specialistë të Ekonomisë	RPC0004568	29	1
35.	Specialistë të Ekonomisë	RPC0004567	24	0
36.	Specialistë të Planifikimit dhe të Arkitekturës Urbane	RPC0004562	32	0
37.	Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës	RPC0004561	17	2
38.	Specialistë të Arkitekturës	RPC0004536	23	1
39.	Specialistë të Planifikimit dhe të Arkitekturës Urbane	RPC0004478	24	3
40.	Specialistë të inxhinierisë të Telekomunikacionit	RPC0004477	10	0
41.	Specialistë të shëndet dhe Higjienës Mjedisore dhe Profesionale	RPC0004476	26	0
42.	Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm	RPC0004437	150	5
43.	Specialistë Financiar	RPC0004200	27	1
44.	Specialistë të Burimeve Njerëzore	RPC0004195	56	2
45.	Specialist i Administrimit të Përgjithshëm	RPC0004173	77	1
46.	Specialistë të Prokurimit Publik	RPC0004049	17	1
47.	Specialistë të Prokurimit Publik	RPC0003996	17	1
48.	Specialistë Ligjor	RPC0003971	32	1
49.	Specialistë Financiar	RPC0003963	24	1
50.	Specialistë të Arkiv Dokumentacionit	RPC0003962	85	1
51.	Specialistë Financiar	RPC0003944	0	0
52.	Specialistë të Përgjithshëm të Mjedisit	RPC0003921	59	8
53.	Specialistë të inxhinierisë të Ndërtimit	RPC0003832	12	*
54.	Specialistë të përgjithshëm të Shëndetit / Mjekësisë	RPC0003831	8	2
55.	Specialistë të Punëve Sociale	RPC0003830	6	3
56.	Specialistë të Punëve Sociale	RPC0003643	41	1
57.	Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale	RPC0003642	46	1
58.	Specialistë të Punëve Sociale	RPC0003360	25	2
59.	Specialistë të Ekonomisë	RPC0003359	50	1
60.	Specialist i Administrimit të Përgjithshëm	RPC0003358	104	1
61.	Specialist i Administrimit të Përgjithshëm	RPC0003357	43	1
62.	Specialistë të Burimeve Njerëzore	RPC0001987	32	1

KONKURSET PËR PRANIM NË SHËRBIMIN PUBLIK

Në konkurset e shpallura për vitet 2022 dhe 2023 për Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese, kanë aplikuar 4,185, ku në vitin 2022 kanë aplikuar 1,357 Aplikantë dhe janë pranuar 186 Kandidatë Fitues, ndërsa për vitin 2023 kanë aplikuar 2,825 Aplikantë, ndërsa janë përzgjedhur 169 Kandidatë Fitues. Për sa i përket konkurset e shpallura për Institucionet Shëndetësore të Kujdesit Primar për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Qendrën e Mjekësisë Urgjente, për këto 2 vite kemi pranuar 1,340 Aplikantë, ndërsa fitues janë përzgjedhur 43 Kandidatë Fitues.

Më poshtë në Grafikonin 4 për Shërbyes Publik në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese për vitin 2022, shih të shprehur në formë vizuale numrin e aplikantëve dhe kandidatëve fitues.




Grafikoni 4

Shprehur në përqindje 13.70% e kandidatëve janë shpallur fitues në konkurse për pranim, ndërsa 86.3% të tjerë nuk janë shpallur fitues.

Në vazhdim në Grafikonin 5 për Shërbyes Publik në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese për vitin 2023, shih të shprehur në formë vizuale numrin e aplikantëve dhe kandidatëve fitues.

Konkursi për Shërbyes Publik në IEAA për Vitin 2023



Grafikoni 5

Shprehur në përqindje 5.98% e kandidatëve janë shpallur fitues në konkurse për pranim, ndërsa 94.02 të tjerë nuk janë shpallur fitues.

Gjithashtu për institucionet vartëse për Teatrin e Qytetit DODONA dhe Qendrën Kulturore të Fëmijëve, janë shpallur konkurset të cilat kanë dështuar në mungesë të Aplikantëve të Kualifikuar. Tashmë është përmbyllur edhe konkursi i radhës për Drejtor të Teatrit të Qytetit, ku i mbetet Këshillit Drejtues të Teatrit Dodona të vazhdoj tutje me procedurat e rekrutimit.

Në vazhdim në Grafikonin 6 për Shërbyes Publik për Institucionet Shëndetësore të Kujdesit Primar (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Qendra e Mjekësisë Urgjente), janë të paraqitura të dhënat vizualisht.

Konkursi për Shërbyes Publik në Institucione Shëndetësore të Kujdesit Primar



Grafikoni 6

Shprehur në përqindje 3.20 % e kandidatëve janë shpallur fitues në konkurs për pranimit të shërbyesve publik, ndërsa 96.8% të tjerë nuk janë shpallur fitues.

Tabela 4 në vazhdim përmbledhë të gjitha konkurset për Shërbyes Publik të cilat janë shpallur nga Kryeqyteti për këtë kategori në Arsim, Shëndetësi dhe Institucione Vartëse të Kryeqytetit.


Nr.	Pozita/Grupi	Njësia	Numri i aplikantëve	Numri i të punësuarve
1.	Konkursi për stafin arsimor në IEAA 2023	Drejtoria e Arsimit	1,357	186
2.	Konkursi për stafin arsimor në IEAA 2022	Drejtoria e Arsimit	2,825	169
3.	Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	Drejtoria e Kulturës	7	0
4.	Drejtor i Teatrit të Qytetit të Prishtinës "Dodona"	Drejtoria e Kulturës	8	0
5.	Konkurs për vendet e lira të punës në QKMF, QMF dhe QMU	Drejtoria e Shëndetësisë	1,340	43

KONKURSET PËR PRANIM SI STAF ADMINISTRATIV/TEKNIK

Krahas kategorive tjera të nëpunësve publik, Sektori i Burimeve Njerëzore ka organizuar edhe procedurat e rekrutimit të Stafit Administrativ/Teknik, duke administruar procedurat e aplikimit, si dhe intervistuar aplikantët për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Gjithësej gjatë vitit 2022-2023, kanë aplikuar 2,251 aplikantë në konkurset për rekrutimin e kësaj kategorie të nëpunësve publik, nga të cilët janë përzgjedhur 9 kandidatë. Konkursi për Zyrtar Administrativ KP 1 dhe KP 2 është anuluar nga ana e Komisionit të Ankesave, pas verifikimit paraprak të 2,103 aplikantëve. Në proces aplikimi dhe të hapura janë 4 pozita për Staf Administrativ/Teknik për Shtëpinë e Pleqëve.

Në vazhdim janë të paraqitur përmes Grafikonit 7 Numri i Aplikantëve dhe Kandidatëve të pranuar për Staf Administrativ Mbështetës (ku pjesë e grafikonit janë edhe Konkurset për Zyrtar Administrativ KP 1 dhe KP 2 të cilat pasi është kryer verifikimi paraprak janë anuluar nga Komisioni i Ankesave të Kryeqytetit).

Konkurset për Staf Administrativ/Teknik



■ Aplikantë ■ Kandidatë Fitues

Grafikoni 7

Shprehur në përqindje 0.39 % e kandidatëve janë shpallur fitues në konkurs për praninë të shërbyesve publik, ndërsa 99.61% të tjerë nuk janë shpallur fitues.

Tabela 5 në vazhdim përmbledhë të gjitha konkurset për Staf Administrativ/Teknik:

Nr.	Pozita/Grupi	Njësia	Numri i aplikantëve	Numri i të punësuarve
1.	Vozitës	Drejtoria e Administratës	50	3
2.	Shtëpiak	Drejtoria e Administratës	20	1
3.	Auto – Larës	Drejtoria e Administratës	20	1
4.	Staf Teknik	Drejtoria e Administratës	13	4
5.	Vozitës	Drejtoria e Shëndetësisë	14	0
6.	Rrobalarës	Drejtoria e Shëndetësisë	20	0
7.	Higjienist	Drejtoria e Shëndetësisë	11	0
8.	Zyrtar Administrativ Kp-01	Drejtoria e Administratës	462	0
9.	Zyrtar Administrativ Kp-02	Drejtoria e Administratës	1641	0
10.	Konkurs per Elektracist	Shtëpia e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare	Në proces	Në proces
11.	Konkurs per Gjellbërës	Shtëpia e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare	Në proces	Në proces
12.	Konkurs per Shtëpiak	Shtëpia e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare	Në proces	Në proces
13.	Konkurs per Vozitës	Shtëpia e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare	Në proces	Në proces

Sa i përket konkurseve në materialin paraprak në formë të detajuar janë të listuara pozitat, drejtoritë dhe numri i kandidatëve dhe aplikantëve për secilin konkurs. Në vazhdim do listohen disa nga angazhimet të cilat vazhdimisht i kryen Sektori i Burimeve Njerëzore të Kryeqytetit.

Zbatimi i Ligjit të Pagave – Gjatë vitit 2023 Sektori i Burimeve Njerëzore ka filluar zbatimin e Ligjit të Pagave për Nëpunësit Publik, duke harmonizuar listën e pagave me obligimet ligjore që dalin nga ky ligj. Gjithashtu sektori ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pran Ministrisë së Punëve të Brendshme, për ekuivalentimin e pagave duke njohur koeficientët për specialistët në bazë të kërkesave të referuara tek ky departament.

Përlogaritja e pagave, pagat retroaktive si dhe konsultimi i nëpunësve për të vazhduar më tutje me kërkesë tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ka zgjatur gjatë gjithë vitit 2023, duke u përgjigjur në kërkesat e pranuar dhe marrë vendimet nga komisioni respektiv në kuadër të DMZP-së.

Plani Vjetor i Trajnimeve – Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi pranon kërkesat dhe sygjerimet nga Drejtoritë dhe Sektorët për tema të caktuara, përkujdeset që të organizoj trajnimet e kërkuara dhe eventualisht të sygjeroj trajnime të cilat ndikojnë direkt në zhvillimin profesional dhe përgatitjen e nëpunësve. Për të përcjellur trendet e reja si dhe për të arritur në një nivel më të mirë të performancës profesionale, listohen trajnimet, përgatitet ngjarja paraprakisht si dhe në varësi të nevojave sigurohet edhe pjesëmarrja e ligjëruesve kompetent që krahas trajnimit edhe të dokumentojnë pjesëmarrjen e nëpunësve përmes dëshmive të pjesëmarrjes/certifikatave, si dhe të njejtat i vendosen në dosjet personale të çdo nëpunësi.

Vërtetimet për njohje të përvojës së punës (angazhimit profesional) – Për nëpunësit aktual si dhe për nëpunësit të cilët kanë qenë të angazhuar më herët, sektori i burimeve njerëzore asiston ata me dokumente (vërtetime) të cilat dëshmojnë periudhën e angazhimit profesional për ata që kanë ndërprerë mardhënien e punës (kanë dalë në pension) apo për personat tjerë që është e nevojshme për zhvillim të mëtutjeshëm profesional.

Aktet juridike (vendime dhe të ngjajshme) – me qëllim lehtësimin e ofrimit të shërbimeve për nëpunësit publik dhe organizimit të punës në shërbimin civil dhe publik të kryeqytetit, sektori përgatitë forma të ndryshme të vendimeve për pezullim vullnetar, urdhëresat për angazhim shtesë, vendim për pezullim për zhvillim profesional, vendim për ndërprerje të mardhënies së punës, vendim për pushim të lehonisë, vendim për pension të parakohshëm si dhe vendime për themelimin të komisioneve.

Komisioni Disiplinor për Shërbyes Civil – i themeluar në bazë të vendimit të nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ (Kryetari i Kryeqytetit), shqyrton raportimet për shkelje disiplinore të nëpunësve civil, për të cilët vlerësohet se kanë shkelur dispozitat ligjore, kan kryer ndonjë shkelje disiplinore apo çështje të ngjajshme që ndikojnë në performancën e punës së nëpunësit civil, duke marrë vendim konform fakteve dhe dëgjimit të personave fizik subjekt i trajtimit nga ana e komisionit.

Komisioni Disiplinor për Shërbyes Publik - i themeluar në bazë të vendimit të nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ (Kryetari i Kryeqytetit), shqyrton raportimet për shkelje disiplinore nga ana e shërbyesve publik, duke vlerësuar saktësinë e raportimeve duke marrë vendim konform fakteve dhe dëgjimit të personave fizik subjekt i trajtimit nga ana e komisionit.

Komisioni i Ankesave – i cili ka qenë i themeluar në bazë të vendimit të nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ (Kryetari i Kryeqytetit) për të shqyrtuar ankesat nga të gjithë zyrtarët publik, ku me rastin e ndryshimit të ligjit për zyrtarë publik, i trajton ankesat e Shërbyesve Publik dhe Stafit Administrativ/Teknik. Trajton paknaqësit dhe ankesat e kandidatëve që aplikojnë për pozita në këto kategori apo për personat në mardhënie pune të cilët si shkallë të parë të ankesës e kanë këtë komision. Gjithashtu kërkesat dhe ankesat individuale trajtohen duke ofruar përgjigje, udhëzuar apo ofruar zgjidhje varësisht nga situata dhe natyra e kërkesës apo ankesës së parashtruar.

Angazhime tjera profesionale dhe administrative që mbështesin punën e drejtorive dhe lehtësimin e punës dhe të performancës së nëpunësve publik.

Data: 11.01.2024
Nr. i Protokollit: 14-052/01-0005847/24

Raporti Vjetor 2022/2023 – Sektori i Burimeve Njerëzore


Ky raport përgatitet nga Sektori i Burimeve Njerëzore, në funksion të përmbushjes së obligimeve ligjore të cilat burojnë nga Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik, gjegjësisht Neni 16 Paragrafi 4.

Punuar nga:



FADIL ALIU
Menaxher i Burimeve Njerëzore

Miraturar nga:



PËRPARIM RAMA
Kryetar i KRYEQYTETIT

